



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË

PROGRAMI

I MBLEDHJES SË VI<sup>të</sup> E KOMITETIT KOMBËTAR TË PAGESAVE (KKSP)

e cila mbahet në mënyrë virtuale nëpërmjet (WEBEX)

të enjten, datë 17 Dhjetor, nga ora 13:00 deri 16:30

**A. Fjala hyrëse e Kryetarit dhe prezantimi i zhvillimeve më të fundit në kuadër të përmbushjes së Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, objektivat afatshkurtër dhe nevojave për rishikime**

**13:00 – 14:00**

|  |  |
|--|--|
| <b>Fjalë hyrëse</b>  | <b>13:00 - 13:05</b><br>Paraqet: Banka e Shqipërisë  |
| <b>Kryetarja e KKSP, Zj. Luljeta Minxhozi</b> në fjalën e saj hyrëse do të përmendë, veç të tjerash, edhe projektet e arritura deri më tani si dhe objektivat e ardhshëm për arritjen e objektivave të synuar për përfshirjen financiare të popullsisë dhe përdorimin e pagesave elektronike.  |  |
| <b>1. Prezantim mbi realizimin e deritanishëm të planit të masave të parashikuara në strategjinë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël dhe nevojat për rishikim të disa afateve dhe objektivave.</b>   | <b>13:05 - 14:00</b><br>Paraqet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Banka e Shqipërisë (DSPKF, DM)</li><li>• Shoqata Italiane e Bankave</li><li>• TIETO &amp; SWIFT</li></ul> |
| <p>a. Prezantim nga <b>Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës</b> në lidhje me arritjet e deritanishme të planit të veprimit të strategjisë, prioritetet afatshkurtra dhe propozime mbi rishikimin e afateve të disa masave bazuar në problematikat dhe nevojat e hasura gjatë zbatimit. (10 min)</p> <p>b. Prezantim nga <b>Departamenti i Mbikëqyrjes</b> mbi afatet dhe masat e nevojshme për zbatimin e ligjit 55/2020 "Për shërbimet e pagesave". (10 min)</p> <p>c. Prezantim nga <b>Shoqata Italiane e Bankave</b> mbi eksperiencën e krijimit dhe operimin të një API (Application Programming Interface) të unifikuar në zbatim të PSD2 me qëllim minimizimin e kostove për aktorët e tregut. (15 min)</p> <p>d. Prezantim nga <b>TIETO</b> në rolin e ofruesit të shërbimit/ infrastrukturës për funksionimin e API të qendëruar, (eksperienca dhe propozime). (10 min)</p> <p>e. Prezantim nga <b>SWIFT</b> në lidhje me shërbimet e ofruara për përmbushjen e kërkesave për komunikim nga API (ISO 20022). (10 min)</p> |  |

**B. Bashkëpunimi ndërinstitucional për digjiitalizim dhe promovimin e inovacionit në Shqipëri- Objektivat dhe sfidat e përbashkëta.**

**14:00 – 15:30**

|  |   |
|--|---|
| <b>2. Tregtia elektronike një prioritet për digjiitalizimin dhe formalizmin e ekonomisë Shqiptare.</b> | <b>14:00 – 14:50</b><br>Paraqet: <ul style="list-style-type: none"><li>• Ministria e Financave dhe Ekonomisë</li><li>• Banka Botërore</li><li>• SWIFT &amp; Paylink</li></ul> |
|--|---|

|  |   |
|--|---|
| <p>a. Prezantim nga <b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Banka Botërore</b> për punën e Grupit Ndërinstitucionale mbi hartimin e planit të veprimit për nxitjen e tregtisë elektronike, objektivat e përbashkëta dhe nevoja për bashkëpunim. (10 min)</p> <p>b. Prezantim nga <b>Banka Botërore</b> për <i>Instant Payment</i>. (15 min)</p> <p>c. Prezantim nga <b>SWIFT</b> në lidhje me shërbimet e ofruara për <i>Instant Payment</i>. (15 min)</p> <p>d. Prezantim nga <b>PAYLINK</b> në lidhje me kostot e procesimit të pagesave me karta dhe hapësirave për reduktim të tyre. (10 min)</p> |   |
| <p><b>3. Edukimi Financiar – Nevoja për koordinim të përpjekjeve dhe hartimin e një strategjie kombëtare për Edukimin Financiar.</b></p>   | <p><b>14:50 – 15:30</b></p>   |
|  | <p>Paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Banka e Shqipërisë (DK)</li> <li>• Shoqata Shqiptare Bankave</li> <li>• AMF</li> </ul> |
| <p>a. Prezantim nga <b>Departamenti i Kërkimeve</b> mbi procesin e Hartimit të Strategjisë për Edukimin Financiar (10 min)</p> <p>b. Prezantim nga <b>Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare</b> mbi angazhimet e objektivat për Edukimin Financiar sidomos mbi legjislacionin e ri të miratuar gjatë vitit (15 min)</p> <p>c. Prezantim nga <b>Shoqata Shqiptare e Bankave</b> në lidhje me zhvillimet gjatë vitit e fushatave të Edukimit Financiar përfshirë fushatën sensibilizuese për përdorimin e kartave bankare. (15 min)</p>  |   |

### C. Zhvillime të tjera

**15:30 – 16:15**

|   |   |
|---|---|
| <p><b>4. Opercionalizimin i pjesëmarrjes së institucioneve financiare jo banka në sistemin AECH</b></p>   | <p><b>15:30 – 15:50</b></p>   |
|   | <p>Paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Banka e Shqipërisë</li> <li>• SWIFT</li> </ul> |
| <p>a. Prezantim nga <b>Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në lidhje me rishikimet rregullative të AECH</b> dhe anëtarësimin e institucioneve financiare në sistem. (10 min)</p> <p>b. <b>Prezantim nga SWIFT</b> mbi mundësitë dhe hapësirat për të ofruar shërbime tek institucionet financiare jo banka në kuadër të përdorimit të sistemit AECH. (10 min)</p>   |   |
| <p><b>5. Masa të ndërmarra gjatë pandemisë</b></p>  | <p><b>15:50 – 16:15</b></p>   |
|   | <p>Paraqet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• AKSHI</li> <li>• Banka e Shqipërisë</li> </ul> |
| <p>a. Prezantim nga <b>Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës në lidhje me rishikimet rregullative të AECH</b> në lidhje me shërbimet Hombanking si dhe rekomandimet në lidhje me nxitjen e mundësive për kryerjen e pagesave nëpërmjet instrumenteve elektronike. (5 min)</p> <p>b. Prezantim <b>AKSHI</b> mbi zhvillimet e ndërmarra nga pikëpamja e nxitjes së pagesave elektronike nëpërmjet platformës e Albania dhe nevoja për bashkëpunim të mëtejshme me sistemin bankar. (10 min)</p> |   |

### D. Të tjera dhe përmbledhje e projekt rekomandimeve të KKSP

**16:15 – 16:30**

|  |                                  |
|--|----------------------------------|
| <p><b>6. Diskutime mbi çështje të tjera, mbi rekomandimet &amp; mbledhjen e radhës</b></p>   | <p><b>16:15 – 16:30</b></p>      |
|  | <p>Paraqet:<br/>Sekretariati</p> |
| <p>Pjesëmarrësit ftohen të diskutojnë mbi çështje me interes për KKSP dhe të cilat nuk janë parashikuar në këtë program si dhe mbi rekomandimet për mbledhjen e radhës.<br/><i>Sekretariati prezanton projekt rekomandimet e KKSP</i><br/>Pjesëmarrësit ftohen të diskutojnë mbi datën e organizimit të mbledhjes së radhës.</p> |                                  |